



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.4.2023

Nr: 415

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PROCEDURALE TEKNIKE PËR ADMINISTRIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK NË BASHKITË VORË, KAMËZ DHE ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 22, pikat 1, 3 e 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 17, datë 13.4.2023, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), për zgjedhjet e organeve vendore, të datës 14 Maj 2023”,

V E N D O S:

1. Miratimin e rregullave procedurale teknike për procesin e votimit elektronik nëpërmjet pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.4.2023 Nr: 415

Ora: 12:00



“Për miratimin e rregullave procedurale teknike për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik në Bashkitë Vorë, Kamëz dhe Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Lidhja 1

RREGULLA PROCEDURALE TEKNIKE PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT NË QV-TË E BASHKIVE ELBASAN, KAMËZ DHE VORË PËR ZGJEDHJET E DATËS 14 MAJ 2023

Pjesa I Votimi

1. Pajisja Elektronike e Votimit dhe Numërimit (PEVN) ku kryhet votimi elektronik shoqërohet nga një kuti e pajisur me printer që mundëson versionin fizik të votës dhe ruajtjen e votës në të.
2. PEVN-ja ka dy memorje USB, të veçanta, një për backup, ku do të ruhen elektronikisht “votat” që do të “hedhin” zgjedhësit. Foleja e memorjeve USB sigurohet me vulë me kod sigurie para daljes nga magazina e KQZ-së, për të mos lejuar ndërhyrjen në to.
3. Kutia shoqëruese do të ketë 5 kode sigurie të cilat do të vendosen ditën e votimit, 4 në pjesët anësore të kutisë dhe një tek dritarja e printerit. KQV pajisjet nga KZAZ me vulat me kode sigurie për pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit model KQZ-00-15.
4. PEVN-ja dhe kutia shoqëruese janë të pajisura me etiketa të dukshme me numrin e QV-së ku do të dërgohen.
5. PEVN-të, kutitë shoqëruese, printerat dhe zarfi me kartat smart dhe kodet PIN të operatorit dorëzohen nga punonjës të KQZ-së pranë KQV-ve me procesverbalin e dorëzimit të pajisjeve PEVN Model KQZ-00-16 ku shënohen nr. serial i pajisjes PEVN dhe numrat e kodit të sigurisë me të cilin është mbyllur valixhja e pajisjes PEVN.
6. KQZ-ja i dorëzon KQV-së, PEVN, kutinë shoqëruese me printer jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit .
7. Në momentin e mbërritjes së pajisjes PEVN dhe kutisë shoqëruese në QV, pranë çdo QV të ketë një person teknik të kontraktuar nga KQZ i cili do të kryej, në prani të një anëtarit të zgjedhur nga partia e shumicës dhe një anëtarit të zgjedhur nga partia opozitare, montimin, testimin dhe pozicionimin e PEVN-ve dhe kutive shoqëruese në ambientin e QV-së.
8. Ditën e votimit, jo më vonë se 1 orë para hapjes së procesit të votimit, operatori teknik merr në dorëzim nga kryetari dhe sekretari i KQV-se pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit duke shënuar në procesverbalin model KQZ-00-38 numrin serial të valixhes që gjendet mbi valixhen e mbyllur, kodin me të cilin është mbyllur valixhja dhe kodin me të cilin është mbyllur foleja USB për secilën pajisje. Operatori në prani të KQV-së kryen ndezjen e pajisjes PEVN, heqjen e kapakut të kutisë ku është montuar printeri dhe u tregon anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve brendësinë e saj. Operatori teknik pajiset nga KQZ me kartën smart dhe kodet pin.
9. Pasi KQV dhe të pranishmit në QV verifikojnë që kutia është bosh, operatori teknik rivendos kapakun me printerin në kuti dhe një nga anëtarët e caktuar nga KQV-ja siguron kutinë në të dyja anët e saj me kode sigurie metalike edhe dritaren e printerit

- me me një kod sigurie plastike. Sekretari i KQV-së shënon kodet e sigurisë në procesverbalin Model KQZ-00-39 dhe në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së.
10. Pasi është vendosur në funksion PEI dhe KQV ka marrë vendim për hapjen e procesit të votimit dhe e ka shënuar në librin e protokollit të mbledhjeve, Kryetari i KQV-së urdhëron operatorin teknik të kryej hapjen e procesit të votimit në PEVN.
 11. Operatori teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN, nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatës bën hapjen e PEVN-ve duke printuar dhe dorëzuar KQV-së raportin e hapjes së votimit i cili duhet të tregojë veç orës së hapjes, numrit të QV-së dhe të pajisjes edhe 0 pjesëmarrës në votim. Ky raport printohet në 8 kopje dhe firmoset nga anëtarët e KQV-së dhe vulozet. Një kopje i dorëzohet sekretarit për ta ruajtur si material zgjedhor një kopje e merr operatori teknik, të tjerat i marrin anëtarët e KQV-së. Ky raport së bashku me procesverbalin KQZ-00-39, i cili plotësohet paraprakisht me kodet e sigurisë, futen në zarfin e posaçëm për administrimin e dokumentacionit elektronik KQZ-08-19.
 12. Një nga anëtarët e KQV-së i ngarkuar me këtë detyrë nga komisioni kryen procesin e aktivizimit për votim të dy PEVN-ve në çdo QV nëpërmjet butonit të tipit pulsant, nga një për secilën pajisje. Kjo detyrë shënohet në vendimin Model KQZ-01-24.
 13. Anëtari i QV nëpërmjet butonit të tipit pulsant aktivizon PEVN-në për votim në kohën kur votuesi, pasi ka kryer me sukses procesin e identifikimit në PEI dhe është timbrosur, shkon tek PEVN për të votuar.
 14. Anëtari i QV mund të kalojë detyrën e hapjes së procesit të votimit të pajisjes PEVN nëpërmjet butonit, tek një anëtar tjetër i KQV-së propozuar nga i njëjti subjekt me të.
 15. Gjatë kohës kur nuk kryhet procesi i votimit në PEVN, butoni i tipit pulsant ka ngjyrë të gjelbër, sa fillon procesi i votimit ngjyra bëhet portokalli dhe qëndron e tillë gjatë gjithë procesit të votimit të një votuesi. Anëtari i QV duhet të aktivizojë procesin e votimit elektronik për votuesin e radhës vetëm kur butoni ka kaluar në ngjyrë të gjelbër.
 16. Votuesi do të ketë mundësi të votojë duke përdorur një ekran me prekje i cili është i thjeshtë në përdorim, ka madhësi të mjaftueshme për të shfaqur të gjitha subjektet zgjedhore dhe kandidatët, apo mesazhet e nevojshme gjatë procesit.
 17. Në ekranin e PEVN-së paraqitet fleta e votimit sipas modelit dhe përmbajtjes së miratuar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj, 2023.
 - a. Fillimisht në ekran shfaqet fleta e votimit për kryetar bashkie, në të cilën ndodhen të renditur kandidatët për kryetar bashkie dhe opsioni “Nuk zgjedh asnjë kandidat”.
 - i. Votuesi mund të zgjedhe kandidatin për kryetar bashkie që dëshiron ose opsionin “nuk zgjedh asnjë kandidat”.
 - ii. Votuesi pasi ka shprehur vullnetin dhe ka zgjedhur një ndër opsionet e “Konfirmim” ose “Ndryshon” zgjedhjen e tij vetëm një herë.
 - b. Menjëherë pasi konfirmon zgjedhjen e tij, në ekran shfaqet fleta e votimit për këshillin e bashkisë.

- i. Votuesi mund të zgjedhë subjektin zgjedhor për këshillin e bashkisë që dëshiron ose opsionin “nuk zgjedh asnjë subjekt”.
 - ii. Votuesi pasi ka shprehur vullnetin dhe ka zgjedhur një ndër opsionet shtyp butonin “Printo Votën”.
 - iii. Votuesi e “Konfirmon” ose “Ndryshon” zgjedhjen e tij vetëm një herë.
18. Votuesi do të ketë mundësi të verifikojë votën e printuar para se ajo të bjerë në kuti. Menjëherë pasi konfirmon zgjedhjen e tij ai mund të shohë me sy të lirë pa patur mundësi ta prekë votën e printuar e cila sigurohet duke u mbuluar nga material transparent.
 19. Votuesi do të ketë mundësinë të mos përzgjedhë asnjë subjekt apo kandidat nëse dëshiron. Në këtë rast fleta e votimit do të printohet dhe pasi votuesi të verifikojë votën e printuar dhe të bëjë konfirmimin e zgjedhjes, fleta do të bjerë në kuti duke u shënuar në kodin QR “nuk zgjedh asnjë subjekt” dhe përlogaritet votë e pavlefshme.
 20. Nëse votuesi ka kryer me sukses gjithë procesin e votimit elektronik, pasi fleta e votimit e printuar do të bjerë në kuti, në ekran do të shfaqet një mesazh konfirmimi për votimin dhe procesi i votimit për votuesin do të mbyllet. Në këtë moment butoni i tipit pulsant, i hapjes manuale të votimit, do të ndryshojë ngjyrën nga portokalli në të gjelbër.
 21. Nëse gjatë procesit të votimit, votuesi largohet nga pajisja e votimit PEVN pa mbyllur procesin e votimit ose qëndron më shumë se 5 minuta në proces votimi, atëherë:
 - a) Pajisja PEVN do të kryejë mbylljen e sesionit të votimit pasi ta ketë paralajmëruar votuesin për skadimin e kohës së votimit.
 - b) Pas kësaj operatori teknik nëpërmjet kartës smart dhe kodit përkatës do të kryej hapjen e pajisjes në mënyrë që votimi të rifillojë në të duke i dhënë mundësinë zgjedhësit të përfundojë votimin.
 - ç) Sekretari shënon në librin e protokollit të mbledhjeve largimin e votuesit pa votuar.
 22. Nëse njëra nga pajisjet për arsye teknike nuk funksionon, votimi vazhdon me pajisjen e dytë të votimi në QV deri në riparimin e defektit. Operatori teknik njofton menjëherë Shërbimin helpdesk për defektin e paraqitur. Sekretari i KQV e shënon këtë fakt dhe orën përkatëse në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të QV dhe njofton menjëherë KZAZ
 23. Nëse të dyja pajisjet në QV shfaqin probleme të cilat nuk mund të riparohen brenda harkut kohor prej 2 orësh, atëherë KQV merr vendim që procesi i votimit të vazhdojë në mënyrë manuale nëpërmjet fletëve të printuar të votimit dhe njofton menjëherë KZAZ-në dhe KQZ-në. Sekretari e shënon këtë fakt në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
 24. PEVN punon e pavarur nga energjia elektrike për 12 orë. Nëse në QV mungon energjia elektrike, nga momenti i vënies në punë të pajisjes PEVN për më shumë se 12 orë pa ndërprerje, duke sjellë fikjen e pajisjes dhe procesi i votimit nuk ka përfunduar për arsyen e përcaktuar në nenin 112, pika 1, të Kodit Zgjedhor, votimi do të vazhdojë vetëm në mënyrë manuale nëpërmjet fletëve të printuar të votimit.

25. Për rastet e përmendura në pikën 24, kur të tabulohet rezultati, totali i votave do të jetë shuma e votave të votimit elektronik dhe atij manual.
26. Në përfundim të procesit të votimit, pasi KQV ka marrë vendimin për mbylljen e votimit, i kërkohet operatorit teknik të kryejë mbylljen e procesit të votimit në secilën pajisje PEVN. Pas mbylljes së votimit secila pajisje PEVN printon raportin e rezultatit të votimit me QR kod për kryetar bashkie dhe këshillin bashkiak, të cilat bien në kutinë shoqëruese.
27. Operatori printon raportin e mbylljes së votimit për secilën pajisje. Raporti i mbylljes së votimit përmban të dhëna për QV-në dhe numrin e pjesëmarrësve në votim për pajisjen. Raporti i mbylljes printohet në 8 kopje për secilin proces votimi, për kryetar bashkie dhe këshillin bashkiak. Raporti firmoset nga anëtarët e KQV-së dhe vuloset. Një kopje e raportit mbahet nga sekretari, një merret nga operatorit teknik dhe nga anëtarë të tjerë nëse e kërkojnë. Raportet e rezultateve me QR kod për çdo PEVN printohen në 8 (tetë) kopje, firmosen nga anëtarët e KQV-së, vulosen dhe u dorëzohen nga një kopje sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së dhe operatorit teknik.
28. Operatori duhet të fotografije procesverbalet e rezultateve për çdo makine dhe të dërgojë fotografitë në kanalet e komunikimit dhe në numrat e përcaktuar nga KQZ-ja. Në rastet kur zona ku ndodhet QV nuk ka mbulim dhe dërgimi i fotove nuk është i mundur, operatori duhet të dërgojë fotot në momentin e parë që mundësohet dërgimi i tyre.
29. Vetëm pasi është mbyllur procesi në PEVN dhe janë printuar raportet e rezultateve sipas pikës 27 të këtij udhëzimi, operatorit teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së vendos në një nga portat USB (ang.) të PEVN-ve modemën USB me kartë SIM, i cili mundëson transmetimin e rezultatit paraprak të PEVN në SEMVR.
30. Nëse gjatë procesit të votimit printeri i kutisë së votimit shfaq problem dhe ka nevojë të ndërrohet/riparohet atëherë:
 - a. KQV vendos pezullimin e procesit të votimit në atë pajisje dhe e shënon tek libri i protokollit të mbledhjeve.
 - b. Operatori teknik kërkon nga KQV prerjen e vulës së dritares së printerit.
 - c. Një anëtar i caktuar nga KQV kryen prerjen e vulës plastike të dritares së printerit.
 - ç. Operatori teknik kryen mbylljen manuale të dritares së printerit dhe kërkon vendosjen e vulës së re plastike në mënyrë që dritarja e printerit të qëndrojë e mbyllur gjatë ndërrimit/riparimit të printerit. Kryetari i KQV-së cakton një anëtar të vendos vulën e re dhe sekretari shënon kodin e vulës në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
 - d. Pasi operatorit teknik kryen ndërrimin/riparimin e printerit ai kërkon nga KQV heqjen e vulës plastike që mbyll dritaren e printerit dhe vulosjen përsëri të dritares së printerit me vulë plastike në pozicionin e mëparshëm.
 - dh. Veprimet e mësipërm shënohen nga sekretari në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

31. Pasi mbyllet procesi i votimit, një anëtar i caktuar nga KQV kryen prerjen e vulës plastike që mban të hapur dritaren e printerit, e pozicionon atë në mënyrë që dritarja e printerit të mbyllet plotësisht dhe rivendoset vula me kode sigurie. Kodi sigurisë së vulës shënohet paraprakisht nga sekretari në procesverbalin e mbylljes së votimit elektronik KQZ-00-40.
32. Pas kësaj operatori teknik kryen çmontimin e printerit nga kutia e votimit, çmontimin e baterisë dhe paketimin e pajisjes PEVN në valixhen përkatëse.
33. KQV fut në kutinë e materialeve zgjedhore kopje të procesverbalit të mbylljes së votimit KQZ-00-40, KQZ-00-38 dhe KQZ-00-39, librin e protokollit të mbledhjeve, dhe materialet e tjera zgjedhore.
34. Pajisjet PEVN së bashku me kutitë shoqëruese do të transportohen nga KQV-ja përkatëse pranë KZAZ për të nxjerrë rezultatin.
35. Plan vendosja tip e një QV-je ku do të përdoret votimi elektronik është sipas figurës së mëposhtme (lidhja 2).
36. KQV, gjatë ditës së votimeve për procedurat jo të automatizuara, ndjek rregullat e përcaktuara në Vendimin nr. 11 datë 25.3.2021 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, i ndryshuar.

Pjesa II Numërimi

KZAZ në përfundim të procesit të votimit do të kryejë këto veprime:

1. Për marrjen në dorëzim të pajisjes PEVN, kutisë shoqëruese me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit nga KQV-të, KZAZ cakton një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim.
2. Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 (dy) anëtarë të KZAZ-së, me përkatësi të ndryshme politike, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.
3. Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të pajisjes PEVN, kutisë shoqëruese me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV.
4. KZAZ-ja cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen PEVN-të, kutitë shoqëruese të votimit dhe kutitë me materiale të votimit para procesit të nxjerrjes së rezultateve dhe pas këtij procesi sipas Plan vendosjes Orientuese bashkëlidhur.
5. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedurë:
 - a. Merr nga sekretari i KZAZ-së procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave i cili është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV si dhe zarfin KQZ-08-19 me procesverbalet dhe raportet e gjeneruara nga PEVN dhe PEI.
 - b. Shënon në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim numrat e kodeve të sigurisë të vulave me të cilat janë mbyllur memoriet USB në PEVN, kutia shoqëruese me fletët e votimit dhe të kutia me materialet e votimit. Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur memoriet USB në PEVN duke ju referuar Procesverbalit KQZ-00-40, kutia shoqëruese me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, me numrat e kodeve të sigurisë të vulave të shënuara në procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave nga KZAZ-ja në KQV.
 - c. Në rast mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë të vulave, grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet “KUTI E PARREGULLT” ose “PEVN e parregullt”.
 - ç. KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen e konstatuar nga grupi i marrjes në dorëzim, dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë si “kuti e parregullt”.
 - d. Mospërputhjet e konstatuara shënohen nga grupi i marrjes në dorëzim në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim të materialeve të votimit nga KQV në KZAZ Model KQZ-00-41, dhe nga KZAZ-ja në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe Procesverbalin e Konstatimit.

- dh. Verifikon nëse mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;
 - e. Verifikon nëse vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
 - ë. Verifikon nëse pajisja PEVN dhe kutitë nuk ka në trupin apo në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë heqjen e memorjeve USB apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit;
 - f. Verifikon nëse PEVN-ja dhe kutitë janë të të njëjtit lloj, formë ose përmasë me ato të përcaktuara me Vendimin e KQZ-së.
 - g. Në rast se Grupi i Marrjes në Dorëzim, gjatë marrjes në dorëzim të PEVN-së, kutisë shoqëruese me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit konstaton të paktën njërën nga parregullsitë e përcaktuara në gërmat “c”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, njofton menjëherë KZAZ-në dhe i kërkon asaj që paisja apo kutia përkatëse të shënohet “KUTI E PARREGULLT”. KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe merr vendim për vlerësimin e tyre.
 - gj. KZAZ-ja, kur konstaton parregullsitë sipas pikave “c”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, vlerëson kutinë si të parregullt, i vendos etiketën “KUTI E PARREGULLT” dhe evidentohet në sistem.
 - h. Të gjitha mospërputhjet apo parregullsitë e konstatuara për secilën PEVN, kuti shoqëruese votimi me fletët e votimit ose për secilën kuti me materialet e votimit të deklaruara të parregullta, shënohen nga KZAZ-ja në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe në Procesverbalin e Konstatimit dhe nga grupi i marrjes në dorëzim në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim .
 - i. Grupi i Marrjes në Dorëzim plotëson Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV-ja përkatëse.
 - j. Procesverbali i Marrjes në Dorëzim nënshkruhet nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari dhe sekretari i KQV-së, dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, i caktuar për shoqërimin e materialeve zgjedhore nga KQV-ja në VNV.
 - k. Originali i Procesverbalit të Marrjes në Dorëzim, administrohet nga KZAZ-ja, kopje të tij i jepen kryetarit, sekretarit të KQV-së, dhe punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili largohet menjëherë me marrjen e kopjes së procesverbalit KQZ-00-41.
6. Në rastet kur për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të PEVN-së, kutisë shoqëruese të votimit dhe kutisë së materialeve të votimit:
- a. PEVN-ja dhe/ose kutia shoqëruese e votimit me fletët e votimit janë vlerësuar “KUTI E PARREGULLT”, atëherë kutia me fletët e votimit dhe kutia përkatëse me materialet e votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta;
 - b. PEVN-ja dhe kutia shoqëruese me fletët e votimit janë marrë në dorëzim të rregullta dhe kutia e materialeve të votimit është vlerësuar nga KZAZ-ja “KUTI E PARREGULLT”, memoria USB e PEVN-së i nënshtrohet procedurave të nxjerrjes së rezultateve. Në çdo rast, parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kutisë së

materialeve të votimit si “KUTI E PARREGULLT”, shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe në Procesverbalin e Konstatimit.

7. PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit, të përcaktuara si “KUTI E PARREGULLT”, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk futen në procesin e nxjerrjes së rezultatit nga KZAZ-ja. Këto PEVN dhe kuti, dërgohen në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit administrativ.
8. PEVN-të dhe/ose kutitë shoqëruese me fletët e votimit të vlerësuara si “KUTI E PARREGULLT”, vendosen në vendin e veçantë të caktuar nga KZAZ-ja për kutitë e parregullta, së bashku me kutinë e materialeve të votimit të QV-së përkatëse.
9. Sapo PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit së bashku me kutitë me materiale të votimit, janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e caktuar. Ky proces mbikëqyret nga KZAZ-ja dhe nga stafi teknik i kontraktuar nga KQZ.
10. PEVN-të dhe kutitë shoqëruese të votimit së bashku me kutitë me materiale të votimit, renditen sipas numrit të Qendrës së Votimit. Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës së tyre. E para në radhë duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh. QV-të “bija” vendosen menjëherë pas QV-së “mëmë”.
11. KZAZ-ja, pasi sigurohet se janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, merr masat paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave si më poshtë:
 - a. Sigurohet që Sistemin Elektronik i Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR) është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve.
 - b. Verifikon që të pranishëm në VNV, janë vetëm:
 - i. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së;
 - ii. Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave të caktuar me vendim të KZAZ-së;
 - iii. Përfaqësuesit e akredituar të medias;
 - iv. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
 - v. Vëzhguesit e tjerë të akredituar;
 - vi. Kandidatët;
 - vii. Operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave;
 - viii. Personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave;
 - ix. Stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim nga KQZ-ja.
12. KZAZ-ja merr vendim për fillimin e procesit të nxjerrjeve të rezultateve pasi ka marrë në dorëzim të gjitha PEVN-të, kutitë shoqëruese të votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të në juridiksionin e saj. Në vendimin për fillimin nxjerrejs së rezultateve shënohet ora e saktë e fillimit. Kryerja e procedurave për veprimet paraprake të mësipërme dhe ora e fillimit të procesit

- nxjerrjes së rezultateve shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së. Rezultatet do të shpallen menjëherë pas agregimit të të dhënave.
13. PEVN-të të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave nxjerrjes së rezultateve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë lidhje.
 14. Refuzimi për të marrë në dorëzim dhe për të ndjekur procedurën e nxjerrjes së rezultateve elektronikisht sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin elektronik ose, sipas rastit, KZAZ-së.
 15. Refuzimi për të kaluar në proces numërimi elektronik memoriet USB të PEVN-së të pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.
 16. Sekretari i KZAZ-së gjatë procesit të nxjerrjeve të rezultateve ndjek procedurën si më poshtë:
 - a. Nën kujdesin e një anëtari të ngarkuar nga KZAZ-ja, merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, PEVN-të të vetëm një QV-je dhe i vendos ato pranë tavolinës së KZAZ-së.
 - b. Merret dosja e KQV-së përkatëse nga dokumentacioni i KZAZ-së, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV. Në dosje ndodhet Procesverbali i dorëzimit të vulave me kodet e sigurisë KQZ-00-15.
 - c. Sekretari i KZAZ-së vendos mbi tryezë PEVN-në e cila ka kartat e memories të vulosur nga KQZ dhe e hap atë, duke këputur vulën me kodin e sigurisë. Tekniku i kontraktuar nga KQZ-ja, vetë ose duke asistuar anëtarin e KZAZ-së të nxjerrë nga pajisja një nga memoriet USB të PEVN-së, tjetrën e lë në pajisje pa e lëvizur.
 - d. Sekretari i KZAZ-së i kërkon teknikut të kontraktuar të KQZ-së të vendosë në SEMVR memorien USB për nxjerrjen e rezultatit për kryetar bashkie dhe subjektet për këshillat bashkiak.
 - e. Sistemi nxjerr tabelat e rezultateve për QV-në për shpërndarjen e votave për kandidatët për kryetar bashkie dhe subjektet për këshillin e bashkisë.
 - f. Anëtarëve të KZAZ-së si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë, u jepen fotokopje të tabelave të rezultateve vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së.
 - g. Pas nxjerrjes së rezultateve të QV-së nga sistemi, memories USB vendoset në folenë përkatëse në PEVN dhe vuloset me vulë të re me kode sigurie që shënohen në tabelën e rezultateve.
 17. Procesi i numërimit të votave për kryetar bashkie dhe subjektet për këshillin bashkiak vazhdon sipas pikës 16 të kësaj lidhje për të gjitha QV-të e ZAZ-së.
 18. Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të votave si më sipër, të të gjitha QV-ve, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga SEMVR-ja Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për Zonën e Administrimit Zgjedhor, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo kandidati dhe subjekti zgjedhor për kryetar bashkie dhe këshillin bashkiak.


19. KZAZ-ja miraton me vendim tabelat permbledhese te rezultatit per kryetar bashkie dhe keshillin e bashkise. Tabelat permbledhese perkatëse për ZAZ-në firmosen nga te gjithë anëtarët e KZAZ-së dhe vulosen nga sekretari i KZAZ.
20. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, Kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim KQZ-së.
21. Kopje të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.
22. Në përfundim të procesit të nxjerrjes së rezultateve, tabelat e rezultateve për QV-të, si per kryetar bashkie dhe keshillin e bashkise, Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në së bashku me dokumentacionin tjetër dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në KQZ

LIDHJA 2

1. Procesi i votimit nëpërmjet pajisjes PEVN do të jetë sipas hapave të mëposhtëm:
 - a. Pajisja PEVN mund të aktivizohet për votim vetëm nëpërmjet butonit të vendosur mbi tavolinën e komisionit përballë një anëtari të QV i ngarkuar me detyrë nga komisioni.
 - b. Pasi anëtari aktivizon sesionin e votimit për votuesin, votuesit do ti shfaqen në ekran fletën e votimit e cila përmban emrat e kandidateve për kryetar bashkie të renditur sipas shortit dhe opsioni “Nuk zgjedh asnjë kandidat”. Fleta e votimit përmban emrin e kandidatit, logon përkatëse të subjektit/koalicionit që e ka propozuar, foton e kandidatit, emrin e plotë të subjektit. Emrat e kandidateve janë të renditur duke filluar nga cepi i majtë lart i ekranit të pajisjes PEVN nga lart poshtë sipas numrit rendor të përcaktuar në short.
 - c. Pasi votuesi përfundon votimin për Kandidatin për Kryetar Bashkie, votuesit do ti shfaqen në ekran fletën e votimit e cila përmban Subjektet politike për Këshillin Bashkiak të renditura sipas shortit dhe opsioni “Nuk zgjedh asnjë subjekt”. Subjektet do të kenë logon përkatëse, emrin e plotë të subjektit, dhe emrin e liderit ose përfaqësuesit të koalicionit. Subjektet janë të renditur duke filluar nga cepi i majtë lart i ekranit të pajisjes PEVN nga lart poshtë sipas numrit rendor të përcaktuar në short.
 - d. Në fund të procesit votuesi pasi të ketë verifikuar dhe konfirmuar zgjedhjen e tij do ti jepet mundësia të printojë votën.
 - e. Nëse votuesi zgjedh opsionin “Nuk zgjedh asnjë kandidat” atij do ti jepet mundësia të printojë votën. Vota e hedhur në këtë rast është votë e pavlefshme. Kjo votë do të përlllogaritet si votë e pavlefshme nga pajisja PEVN.
 - f. Në përfundim të procesit të votimit pajisja PEVN do ti shfaqë votuesit një mesazh konfirmimi për votimin me sukses dhe do të kryej mbylljen e ndërfaqes së votimit.

g. Afati maksimal për përfundimin e votimit për një votues që nga momenti i hapjes së sesionit të votimit do të jetë 5 minuta.

2. Plan vendosja tip e një qendre votimi nëpërmjet pajisjes PEVN.



3. Vulosja e pajisjes PEVN



4. Vulosja e kutisë së votimit elektronik.





MODEL KQZ-00-15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

KQV	Nr:	
Datë:		Ora:

PROCESVERBAL
I PAJISJES ME VULAT ME KODE SIGURIE
Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vulat me kode të sigurisë
për votimin elektronik me PEVN

KZAZ Nr. _____, pajis KQV Nr. _____ vula me kode të sigurisë për ti përdorur në procedurën e votimit dhe numërimit elektronik me pajisjen PEVN.

Nr.	Kodi i vulës së sigurisë metalike
1	9
2	10
3	11
4	12
5	Kodi i vulës së sigurisë rezervë metalike
6	1
7	2
8	3
	Kode plastike të sigurisë
1	6
2	7
3	8
4	9
5	10

Ky procesverbal mbahet në 3 (tre) kopje. Një nga kopjet e procesverbalit dorëzohet nga KZAZ në KQZ.

Dorëzuesi nga: KZAZ _____

Marrësi në dorëzim nga KQV nr. _____

Kryetar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Kryetar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Zv/Kryetar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Vula



MODEL KQZ-00-16

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

KQV	Nr:	
Datë:		Ora:

PROCESVERBAL
PËR DORËZIMIN E PAJISJEVE PEVN NGA KQZ - KQV

Pajisjet PEVN, të përcaktuara për KQV _____, dorëzohen nga përfaqësuesi i KQZ-ës, KQV-ës

I. Pajisje PEVN 2 Copë të mbyllura në valixhe me kod sigure dhe numur serial si me poshtë

Plotësohet në KQV

Nr.	Pajisja elektronike (PEVN)	Nr. Serial që gjendet mbi valixhe	Kodi i sigurisë me të cilin është e mbyllur valixhja
1	PEVN 1		
2	PEVN 2		

II. Kutitë shoqëruese - 2 copë

III. Printera - 2 copë

IV. Zarfi me Kartat Smart dhe Kodet PIN te operatorit të mbyllura në valixhe

KUJDES!

Ky procesverbal mbahet në 2 (dy) kopje. Një kopje mbahet nga KQZ-ja (dorëzuesi).

Një kopje e procesverbalit mbahet nga KQV-ja dhe futet ne kutinë e materialeve zgjedhore.

Për KQZ, Dorëzuesi:

KQV

(emër, mbiemër, firmë)

Anëtar:

(emër, mbiemër, firmë)

Anëtar:

(emër, mbiemër, firmë)

Vula



MODEL KQZ-00-38

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

QV	Nr:	
Datë:		Ora:

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 14 maj 2023

PROCESVERBAL KQV- OPERATOR
Për dorëzimin e pajisjeve të pevn

A – Para fillimit të procesit të votimit

Dorëzimi i pajisjeve PEVN nga KQV tek OPERATORI

PAJISJA	Shëno numrin serial të PEVN që gjendet mbi valixhen mbyllur	Shëno kodin me të cilin është mbyllur valixhja përpara	Shëno kodin me të cilin është mbyllur foleja e USB
Pajisja PEVN 1			
Pajisja PEVN 2			

Folete e USB-ve janë të vulosura me Kode Sigurie

PO JO

Pajisja është e dëmtuar

PO JO

Nëse po, përshkruaj llojin e dëmtimit

Operator

Emër, mbiemër, firmë

Kryetari KQV

Emër, mbiemër, firmë

Sekretar i KQV

Emër, mbiemër, firmë

Vula
KQV

B - Pas mbylljes së votimit

Datë:

Ora:

PAJISJA	Shëno numrin serial të PEVN që gjendet mbi valixhen mbyllur	Shëno kodet me të cilat janë mbyllur folete e USB-ve.
Pajisja PEVN 1		
Pajisja PEVN 2		

Folete e USB-ve janë të vulosura me Kode Sigurie

PO JO

Pajisja është e dëmtuar

PO JO

Nëse po, përshkruaj llojin e dëmtimit

Operator

Emër, mbiemër, firmë

Kryetari KQV

Emër, mbiemër, firmë

Sekretar i KQV

Emër, mbiemër, firmë

KZAZ/ Grupi Marrjes në dorëzim

Emër, mbiemër, firmë

1 kopje e këtij procesverballi futet në kutinë e materialeve zgjedhore, 1 kopje e mban operatori,
2 kopje i dorëzohen dorazi KZAZ-sëVula
KQVVula
KZAZ



MODEL KQZ-00-39

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

KQV	Nr:	
Datë:		Ora:

PROCESVERBAL

I VULOSJES SË KUTIVE SHOQËRUESE TË PEVN-ve DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK

Bazuar në nenin 101, paragrafi 1, shkronja "e", të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, përpara fillimit të votimit, kutitë shoqëruese elektronike e pajisjeve PENV vulosen me kodet e sigurisë me numër si më poshtë:

I. KUTIA SHOQËRUESE E VOTIMIT PAJISJA PEVN 1

Kutia e shoqëruese e votimit mbyllet me 4 (katër) kode sigurie metalike

1)	2)	3)	4)
Dritarja e printerit mbyllet me kod sigurie plastik		1)	

II. KUTIA SHOQËRUESE E VOTIMIT PAJISJA PEVN 2

Kutia e shoqëruese e votimit mbyllet me 4 (katër) kode sigurie metalike

1)	2)	3)	4)
Dritarja e printerit mbyllet me kod sigurie plastik		1)	

III. PAJISJET JANE TË MBYLLYR NË FOLENË E MEMORJES USB ME KODET

PEVN 1 Kodi		PEVN 2 Kodi	
-------------	--	-------------	--

IV. Shëno kodet të cilat janë dëmtuar gjatë mbylljes së kutive shoqëruese të PEVN-ve:

1)	2)	3)
----	----	----

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1		Kryetar		
2		Sekretar		
3		Anëtar		
4		Anëtar		
5		Anëtar		
6		Anëtar		
7		Anëtar		



KUJDES! Origjinali i këtij procesverballi, mbyllet në "Zarfin e Procesverballit të Vulosjes KQZ-08-19", ndërsa kopja e dytë futet në kutinë e materialeve zgjedhore. Këto Kode shkruhen edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të QV.

Vota



MODEL KQZ-00-40

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:	
BASHKIA:	

KQV	Nr:
Datë:	Ora:

PROCESVERBAL
I MBYLLJES SË VOTIMIT ELEKTRONIK

Të dhëna për zgjedhësit dhe votimin	me shifër	me fjalë	
1. Shëno numrin e zgjedhësve që kanë votuar			
a) Shëno numrin e zgjedhësve që janë identifikuar nëpërmjet pajisjes PEI			
b) Shëno, në se ka, numrin e zgjedhësve që nuk janë identifikuar nëpërmjet pajisjes PEI por nëpërmjet listës së zgjedhësve.			
c) Shëno numrin e zgjedhësve gra			
2. Numri total i pjesëmarrësve në votim			
a) Numri i pjesëmarrësve në votim PEVN 1			
b) Numri i pjesëmarrësve në votim PEVN 2			
I. Memoriet USB te pajisjeve PEVN			
a) Memoria USB e pajisjes PEVN 1, është e mbyllur me kod sigurie			
b) Memoria USB e pajisjes PEVN 2, është e mbyllur me kod sigurie			
II. Mbyllja e dritares së printerit në kutitë shoqëruese të votimit			
1. Kodi i vulës së pestë për mbylljen e dritares së printerit kutia PEVN 1			
2. Kodi i vulës së pestë për mbylljen e dritares së printerit kutia PEVN 2			
Në rast se vula(t) me kodet e sigurisë dëmtohen gjatë mbylljes, ajo zëvendësohet me vulat rezerve me kodet :			
1)	2)	3)	
III. Kutia e materialeve zgjedhore mbyllet me vulat me kode sigurie :			
1)	2)	3)	4)
Në rast se vula(t) me kodet e sigurisë dëmtohen gjatë mbylljes, ajo zëvendësohet me vulat rezerve me kodet :			
1)	2)	3)	
Vërejtje të anëtarëve të KQV _____			

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1		Kryetar		
2		Sekretar		
3		Anëtar		
4		Anëtar		
5		Anëtar		
6		Anëtar		
7		Anëtar		

Vula



MODEL KQZ-00-41

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ Nr:		KQV	Nr:
BASHKIA:		Datë:	Ora:

PROCESVERBAL

I DORËZIMI TË MATERIALEVE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK NGA KQV NË KZAZ

Komisioni i Qendrës së Votimit, në zbatim të nenit 115, paragrafët 2, 3, 4, 7 dhe 8, të ligjit 100/19, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë", të ndryshuar, dorëzon

1	KUTITË SHOQËRUESE TË VOTIMIT				
	1.1 Kjo kuti votimi 1 është:	1.2. Nëse kutia e votimit është ë parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:			
	a. e rregullt <input type="checkbox"/> b. e parregullt <input type="checkbox"/>	_____			
	Kutia Shoqeruese e Votimit PEVN 1 është e vulosur me 5 (pese) kode sigurie:				
	1)	2)	3)	4)	5)
	1.2 Kjo kuti votimi 2 është:				
	a. e rregullt <input type="checkbox"/> b. e parregullt <input type="checkbox"/>	_____			
	Kutia Shoqëruese e Votimit PEVN 2 është e vulosur me 5 (pesë) kode sigurie				
	1)	2)	3)	4)	5)
2	FOLE E MEMORIVE USB NË PAJISJEN PENV ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, ME KODE SIGURIE:				
	Pajisja PENV ka një fole memorie USB, e cila duhet të jetë e vulosur me 1 vulë metalike me kod sigurie				
	Pajisja PEVN 1, foleja e USB është e vulosur me vulë metalike me Kod Sigurie				
	Pajisja PEVN 2, foleja e USB është e vulosur me vulë metalike me Kod Sigurie				
3	KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE				
	Kutia e Materialeve Zgjedhor duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode sigurie				
	3.1 Kutia e materialeve zgjedhore është:	3.2. Nëse kutia e materialeve zgjedhore është ë parregullt, shëno parregullsitë e konstatuara:			
	a. e rregullt <input type="checkbox"/> b. e parregullt <input type="checkbox"/>	_____			
	KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:				
	1)	2)	3)	4)	

Punonjësi i Policisë së Shtetit:

(emër, mbiemër, firmë)

Dorëzuesi nga: KQV nr. _____

Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marjes në dorëzim:

Kryetar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Anëtar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Anëtar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Ky procesverbal mbahet në 4 (katër kopje). KZAZ është e detyruar të dorëzojë kopjen e parë në KQZ. Kopje e dytë mban KZAZ-ja. Kopja e tretë i jepet KQV-ës dhe një kopje e merr Punonjësi i Policisë së Shtetit që ka shoqëruar KAV për në KZAZ.